

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 4115 Prot.

Tiranë, më 30.06 . 2025

Lënda: Për njohje dhe zbatim.

AGJENCISË KOMBETARE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR


Rruga "Aleksandër Moisiu", Tiranë

Bashkëlidhur, ju dërgojmë për njohje dhe zbatim, Urdhrin nr. 280, datë 26.6.2025 "Për përcaktimin e Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar për zbatimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë "Për oficerët e sigurisë në shkollat publike".

Zyra e Koordinimit e ngritur në AKAP, do të vlerësojë dokumentacionin mbi aplikimin për këtë thirrje, brenda afateve të përcaktuara në shpallje.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 4021 / Prot.
11

Tiranë, më 26.06.2025

URDHËR

Nr. 280, datë 26.06.2025

PËR

**PËRCAKTIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
PËR ZBATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT NDËRMJET
MINISTRISË SË BRENDSHME DHE MINISTRISË SË ARSIMIT, SPORTIT DHE
RINISË "PËR OFICERËT E SIGURISË NË SHKOLLAT PUBLIKE"**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 26 të ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të vendimit nr. 99, datë 27.2.2019 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar", i ndryshuar, të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë "Për oficerët e sigurisë në shkollat publike" me nr. 6068 prot., datë 01.06.2018, si dhe të urdhrit nr. 609, datë 20.12.2024 "Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, znj. Orjana Osmani",

URDHËROJ:

1. Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar (AKAP), në rolin e Zyrës së Koordinimit dhe Monitorimit, ndjek zbatimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit të lidhur ndërmjet Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë "Për oficerët e sigurisë në shkollat publike" me nr. 6068 prot., datë 01.06.2018 (më poshtë "Marrëveshja e Bashkëpunimit").
2. Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar të kryejë detyrat si më poshtë:
 - a) të koordinojë dhe monitorojë zbatimin e detyrimeve të përcaktuar në Marrëveshjen e Bashkëpunimit që lidhen me fushën e përgjegjësisë së arsimit parauniversitar;
 - b) të ndjekë procedurat e punësimit të oficerëve të sigurisë në shkollat publike për t'u zbatuar nga drejtoritë rajonale arsimore parauniversitare (DRAP) dhe zyrat vendore arsimore parauniversitare (ZVAP) përkatëse;

- c) të koordinojë dhe bashkëpunojë me Akademinë e Sigurisë dhe organizatat partnere për planifikimin e trajnimeve për oficerët e sigurisë në shkolla;
 - d) të raportojë te Ministri përgjegjës për arsimin periodikisht për ecurinë e zbatimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit.
3. Për thirrjen e shpallur në datë 11.06.2025 "Për shprehje interesi për kandidatët për oficerë sigurie në institucionet e arsimit parauniversitar publik" të gjitha procedurat në vijim të kryhen nga AKAP.
4. Komisioni i Intervistimit në vijim të përbëhet nga 1 (një) anëtar nga MAS, 1 (një) anëtar nga AKAP, 2 (dy) anëtarë të caktuar nga Ministria e Brendshme dhe 1 (një) anëtar nga Urdhri i Psikologut.
5. Urdhri nr. 541, datë 15.09.2022 "Për ngritjen e Zyrës së Koordinimit dhe Monitorimit për zbatimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Ministrinë e Brendshme "Për oficerët e sigurisë në shkollat publike"", i ndryshuar, shfuqizohet.
6. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbështetëse, si dhe Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSMINISTRI

ORJANA OSMANI

